



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:213293
Datë: 19.04.2024
Numri i dokumentit: 05595608

PAKR.nr.150/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për të Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku, dhe Kadrije Goga Lubishtani, anëtar, me bashkëpunëtoren profesionale Ardianë Morina, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.L., nga Prizreni, për shkak të veprës penale grabitja nga neni 317 par.3 lidhur me par.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesave, të Prokurorisë Themelore në Prizren dhe mbrojtësit së të akuzuarit, av.Rexhep Kabashi, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.113/2023, të dt.11.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.12.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat, e Prokurorisë Themelore në Prizren, dhe mbrojtësit së të akuzuarit B.L., av.Rexhep Kabashi, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.113/2023, të dt.11.01.2024, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.113/2023, të dt.11.01.2024, është shpallur fajtor i akuzuari B.L., për shkak të veprës penale grabitja nga neni 317 par.3 lidhur me par.1 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatja prej 6 (gjashtë) viteve, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga dt.08.10.2023, e gjerë në përfundim të dënimit të shqiptuar me burg, por jo më shumë se dënimi i shqiptuar. Po ashtu i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në shumën prej 300 (treqind) Euro, të cilin dënim është i obliguar që të paguaj në afat prej 15 ditëve, në të kundërtën i njëjti do ti shndërrohet në dënimin me burgim, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar nga 20 Euro, në kuptim të nenit 43 par.3 të KPK.

Është obliguar i akuzuari që të dëmtuarës Telekomit i Kosovës SHA, t'ia kompensoj dënimin në shumën prej 50 Euro.

E dëmtuara D.T., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është udhëzuar në kontestin e rregullt civilo - juridik.

Në kuptim të nenit 110 par.13 dhe 18 dhe lidhur me nenin 113 të KPPK, të akuzuarit B.L., i kthehet telefoni i markës "Samsung J2", ngjyrë të zezë me numër të iemilit:351813102271286/01.

Me aktvendim të posaçëm i është vazhduar paraburgimi të akuzuarit.

Është obliguar i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale, sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, paushallin gjyqësor në shumën prej 50 Euro, si dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, shumën prej 50 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë kanë ushtruar:

-Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.113/2023, i dt.11.01.2024, të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i ashpër me burgim, në atë mënyrë që të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit, si dhe

-mbrojtësi i të akuzuarit B.L., av.Rexhep Kabashi, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, që aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.113/2023, i dt.11.01.2024, të ndryshohet dhe të akuzuarit B.L., ti shqiptohet dënim më i butë.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/I.nr.149/2024, të datës 13.03.2024, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e ushtruar, nga ana e Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, ka propozuar që e njëjta të aprovohet si e bazuar, ashtu që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe të akuzuarit B.L., ti shqiptohet dënim me burgim më i ashpër, kurse sa i përket ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit B.L., av.Rexhep Kabashi, e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Në kuptim të nenit 390 të KPPK, kolegji i kësaj gjykate ka caktuar seancën e kolegjit për dt.12.04.2024, dhe në mënyrë të rregullt i ka njoftuar të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Në seancë të kolegjit ka prezantuar i akuzuari B.L., mbrojtësi i të akuzuarit, av.Rexhep Kabashi, ndërsa nuk ka prezantuar Prokurori i Apelit, si dhe e dëmtuara D.T., përkundër asaj që janë njoftuar në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet nga shkresat e lëndës.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.L., av.Rexhep Kabashi, në seancë të kolegjit ka propozuar që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pabazuar, ndërsa ankesa e tij të aprovohet si e bazuar, duke i shqiptuar të akuzuarit dënim më të butë me burgim, i cili do të jetë adekuat përgjegjësisë penalo juridike të akuzuarit.

I akuzuari B.L., ka deklaruar se e përkrah në tërësi ankesën e mbrojtësit, si dhe paraqitjen e tij në seancë të kolegjit.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesat e ushtruara, nga ana e Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, si dhe e mbrojtësit së të akuzuarit B.L., av.Rexhep Kabashi, aktgjykimi të ankimit, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesat, e Prokurorisë Themelore në Prizren, si dhe e mbrojtësit së të akuzuarit B.L., av.Rexhep Kabashi, nuk janë të bazuara

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkalës së parë nuk është ankimit për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, kolegji i kësaj gjykate e ka shqyrtuar aktgjykimin si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet procedurale, të cilat ndërlidhen me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, në kuptim të nenit 384 të KPPK, për të cilat shkelje kolegji i Gjykatës së Apelit, sipas detyrës zyrtare përkujdeset në pajtim të nenit 394 të KPPK, ashtu që ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të kushtëzohin anulimin e tij, si dhe shkeljet e ligjit penal, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prizren, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimit për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke theksuar se gjykata në rastin e marrjes së vendimit për dënimin, ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese, sikurse janë se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, se është i gjendjes së varfër ekonomike, se është baba i katër fëmijëve, e po ashtu ka vlerësuar edhe rrethanat rënduese sikurse janë mënyra e kryerjes së veprës penale, si dhe shkalla e intensitetit të kryerjes së të njëjtit, e posaçërisht ka pasur motivin e kryerjes së veprës penale, që është pasurim i pa bazë, me qëllim që vetit ti sjellë dobi pasurore të kundërligjshme, se kjo natyrë dhe lloji i veprave penale janë në rritje e sipër, të kaluarën kriminale të akuzuarit, e cila rezulton nga aktgjykimet e plotfuqishme: Aktgjykimi P.nr.845/2012 i plotfuqishëm më 21.09.2012, për veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 145, i dënuar me 6 muaj burgim; Aktgjykimin P.nr.2210/2015, i plotfuqishëm më 20.12.2016, për veprën penale vjedhja nga neni 325, i dënuar me dënim me kusht prej 4 muaj në afat verifikimi prej 1 viti; Aktgjykimi P.nr.791/2017 i plotfuqishëm më datë 17.07.2018, për veprën penale vjedhja nga neni 325, i dënuar me 8 muaj me kusht në afat verifikimi prej 1 viti; Aktgjykimi P.nr.930/2017 i plotfuqishëm më 04.07.2018, për veprën penale vjedhja nga neni 325, i dënuar me dënim me gjobë prej 200 Euro dhe dënim me kusht prej 3 muaj në afat verifikimi prej 1 viti; Aktgjykimi P.nr.1137/2017 i plotfuqishëm më 06.08.2018, për veprën penale vjedhja nga neni 325, i dënuar

me 1 vit dënim me kusht në afat verifikimi prej 2 vitesh; Aktgjykimin P.nr.1235/2017 i plotfuqishëm më 28.05.2018, për veprën penale vjedhja nga neni 325, i dënuar me 1 vit dënim me kusht në afat verifikimi prej 2 vitesh; Aktgjykimin P.nr.1345/2017 i plotfuqishëm më 16.07.2018, për veprën penale vjedhja, i dënuar me 1 vjet burgim me kusht në afat prej 2 vitesh dhe 100 Euro gjobë, P.nr.1433/2017, i plotfuqishëm më 01.08.2018, për veprën penale vjedhja nga neni 325, i dënuar me 1 vit dënim me kusht në afat verifikimi prej 2 vitesh, Aktgjykimin P.nr.2070/2017 i plotfuqishëm më 18.06.2018, për veprën penale kanosja nga neni 185, i dënuar me vjedhja nga neni 325, i dënuar me 3 muaj dënim me kusht në afat verifikimi prej 1 viti, Aktgjykimin P.nr.2167/2017, i plotfuqishëm më 03.07.2018, për veprën penale vjedhja e rëndë nga neni 327, i dënuar me 6 muaj burgim dhe me gjobë prej 150 Euro, Aktgjykimin P.nr.2217/2017 i plotfuqishëm më 28.06.2018, për veprën penale vjedhja nga neni 325, i dënuar me 6 muaj burgim dhe me gjobë prej 150 Euro, Aktgjykimin P.nr.2404/2017 i plotfuqishëm më 11.12.2018, për veprën penale vjedhja nga neni 325, i dënuar me gjobë prej 150 Euro, Aktgjykimin P.nr.33/2018, i plotfuqishëm më 12.02.2019, për veprën penale vjedhja nga neni 325, i dënuar me 3 muaj dënim me kusht në afat verifikimi prej 1 vitesh dhe dënim me gjobë prej 200 Euro, Aktgjykimin P.nr.203/2018 i plotfuqishëm më 08.07.2019, për veprën penale vjedhja nga neni 325, i dënuar me 3 muaj dënim me burgim dhe dënim me gjobë prej 250 Euro, Aktgjykimin P.nr.207/2018 i plotfuqishëm më 25.09.2018, për veprën penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345, i dënuar me 1 vit burgim dhe 400 Euro gjobë, Aktgjykimin P.nr.595/2018, i plotfuqishëm më 21.01.2019, për veprën penale vjedhja nga neni 325, i dënuar me i dënuar me 3 muaj dënim me burgim me kusht në afat verifikimi prej 1 viti, Aktgjykimin P.nr.1610/2018, i plotfuqishëm më 18.03.2020, për veprën penale vjedhja nga neni 325 dhe Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345, i dënuar me 3 muaj burgim dhe 100 Euro me gjobë, Aktgjykimin P.nr.2526/2016 i plotfuqishëm 31.01.2020, për veprën penale vjedhja nga neni 325, i dënuar me 6 muaj dënim me kusht në afat verifikimi prej 1 viti dhe 200 Euro gjobë, Aktgjykimin P.nr. 1420/2017, i plotfuqishëm 5.11.2021, për veprën penale vjedhja nga neni 325, i dënuar me 200 Euro gjobë dhe 6 muaj dënim me burgim me kusht në afat verifikimi prej 1 vitesh, Aktgjykimin P.nr.233/2018, i plotfuqishëm 21.12.2020, për veprën penale vjedhja nga neni 325, i dënuar me 3 muaj burgim dhe gjobë prej 350 Euro në afat verifikimi prej 1 viti, ashtu që në prani të këtyre rrethanave jemi të mendimit se të akuzuarit i është dashur që ti shqiptohet dënim më i ashpër me të cilin do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit.

Po ashtu ankesë për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, ka ushtruar edhe mbrojtësi i të akuzuarit B.L., av.Rexhep Kabashi, duke pretenduar në ankesë se gjykata e shkallës së parë, nuk i ka vlerësuar në masë të duhur të gjitha rrethanat lehtësuese, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë lidhur me veprën penale të grabitjes nga neni 317 par.3 lidhur me par.1 të KPK, se pranimin e fajësisë e ka bërë që në seancën fillestare, se ka shpreh keqardhje për veprën e kryer penale dhe ka kërkuar falje publikisht të dëmtuarës, se ka shpreh gatishmëri që dëmin e shkaktuar ta kompensoj, andaj në prani të këtyre rrethanave është dashur ta aplikoj institutin e zbutjes së dënimit, konform nenit 71 par.1 nën par.1.1, 1.2, dhe 1.3 të KPK, lidhur me nenin 72 par.1 nën par.1.2 të KPK, dhe ti shqiptoj dënim më të butë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sipas ankesës së prokurorisë, si dhe mbrojtësit së të akuzuarit B.L., av.Rexhep Kabashi, përkitazi me vendimin lidhur me sanksionin penal, si dhe shkresat e tjera të lëndës dhe ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë e cila rezulton nga shkresat e lëndës, nga se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe pasi që pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht dhe në kuptim të dispozitave përkatëse ligjore. Gjykata e shkallës së parë me rastin marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të lartësisë dhe llojit të tij, ka vlerësuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPK, e posaçërisht ka pasur parasysh se i akuzuari e ka pranuar fajësinë sipas të gjitha pikave të aktakuzës, ashtu që janë plotësuar kushtet ligjore, për pranimin e fajësisë nga ana e gjykatës, pasi që i akuzuari e ka pranuar të njëjtën. Po ashtu duke u mbështetur në të gjitha provat nga shkresat e lëndës, sikurse provat personale po ashtu edhe ato materiale, rezulton se gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën për të gjitha propozimet e ngritura dhe ka ardhur në përfundim se janë vlerësuar të gjitha rrethanat në mënyrë të drejtë të parapara në nenin 69 dhe 70 të KPK. Si rrethana rënduese ka vlerësuar se i akuzuari edhe më parë ka ra në kundërshtim me ligjin, e cila vërtetohet nga evidenca kriminale e të akuzuarit, e sidomos sipas: Aktgjykimi P.nr.845/2012 i plotfuqishëm më 21.09.2012, për veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 145, i dënuar me 6 muaj burgim; Aktgjykimin P.nr.2210/2015, i plotfuqishëm më 20.12.2016, për veprën penale vjedhja nga neni 325, i dënuar me dënim me kusht prej 4 muaj në afat verifikimi prej 1 viti; Aktgjykimi P.nr.791/2017 i plotfuqishëm më datë 17.07.2018, për veprën penale vjedhja nga neni 325, i dënuar me 8 muaj me kusht në afat verifikimi prej 1 viti; Aktgjykimi P.nr.930/2017 i plotfuqishëm më 04.07.2018, për veprën penale vjedhja nga neni 325, i dënuar me dënim me gjobë prej 200 Euro dhe dënim me kusht prej 3 muaj në afat verifikimi prej 1 viti; Aktgjykimi P.nr.1137/2017 i plotfuqishëm më 06.08.2018, për veprën penale vjedhja nga neni 325, i dënuar me 1 vit dënim me kusht në afat verifikimi prej 2 vitesh; Aktgjykimin P.nr.1235/2017 i plotfuqishëm më 28.05.2018, për veprën penale vjedhja nga neni 325, i dënuar me 1 vit dënim me kusht në afat verifikimi prej 2 vitesh; Aktgjykimin P.nr.1345/2017 i plotfuqishëm më 16.07.2018, për veprën penale vjedhja, i dënuar me 1 vjet burgim me kusht në afat prej 2 vitesh dhe 100 Euro gjobë, P.nr.1433/2017, i plotfuqishëm më 01.08.2018, për veprën penale vjedhja nga neni 325, i dënuar me 1 vit dënim me kusht në afat verifikimi prej 2 vitesh, Aktgjykimin P.nr.2070/2017 i plotfuqishëm më 18.06.2018, për veprën penale kanosja nga neni 185, i dënuar me vjedhja nga neni 325, i dënuar me 3 muaj dënim me kusht në afat verifikimi prej 1 viti, Aktgjykimin P.nr.2167/2017, i plotfuqishëm më 03.07.2018, për veprën penale vjedhja e rëndë nga neni 327, i dënuar me 6 muaj burgim dhe me gjobë prej 150 Euro, Aktgjykimin P.nr.2217/2017 i plotfuqishëm më 28.06.2018, për veprën penale vjedhja nga neni 325, i dënuar me 6 muaj burgim dhe me gjobë prej 150 Euro, Aktgjykimin P.nr.2404/2017 i plotfuqishëm më 11.12.2018, për veprën penale vjedhja nga neni 325, i dënuar me gjobë prej 150 Euro, Aktgjykimin P.nr.33/2018, i plotfuqishëm më 12.02.2019, për veprën penale vjedhja nga neni 325, i dënuar me 3 muaj dënim me kusht në afat verifikimi prej 1 vitesh dhe dënim me gjobë prej 200 Euro, Aktgjykimin P.nr.203/2018 i plotfuqishëm më 08.07.2019, për veprën penale vjedhja nga neni 325, i dënuar me 3 muaj dënim me burgim dhe dënim me gjobë prej 250 Euro, Aktgjykimin P.nr.207/2018 i plotfuqishëm më 25.09.2018, për veprën penale Blerja, pranimi ose

fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345, i dënuar me 1 vit burgim dhe 400 Euro gjobë, Aktgjykimin P.nr.595/2018, i plotfuqishëm më 21.01.2019, për veprën penale vjedhja nga neni 325, i dënuar me 3 muaj dënim me burgim me kusht në afat verifikimi prej 1 viti, Aktgjykimin P.nr.1610/2018, i plotfuqishëm më 18.03.2020, për veprën penale vjedhja nga neni 325 dhe Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345, i dënuar me 3 muaj burgim dhe 100 Euro me gjobë, Aktgjykimin P.nr.2526/2016 i plotfuqishëm 31.01.2020, për veprën penale vjedhja nga neni 325, i dënuar me 6 muaj dënim me kusht në afat verifikimi prej 1 viti dhe 200 Euro gjobë, Aktgjykimin P.nr. 1420/2017, i plotfuqishëm 5.11.2021, për veprën penale vjedhja nga neni 325, i dënuar me 200 Euro gjobë dhe 6 muaj dënim me burgim me kusht në afat verifikimi prej 1 vitesh, Aktgjykimin P.nr.233/2018, i plotfuqishëm 21.12.2020, për veprën penale vjedhja nga neni 325, i dënuar me 3 muaj burgim dhe gjobë prej 350 Euro në afat verifikimi prej 1 viti, të cilat gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar, dhe i ka shqiptuar të akuzuarit sikurse në dispozitiv të aktgjykimit.

Nga ankesa e prokurorisë, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht rënduese, sikurse nuk ka gjetur as nga ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit, ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, andaj kolegji ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të paraparë në nenin 38 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.150/2023, të datës 12.04.2024

Bashkëpunëtorja profesionale,
Ardianë Morina

Anëtarët e kolegjit,
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit,
Xhevdet Abazi

Kadrije Goga Lubishtani